

Ali M. Ahmeti

## TAPONIMET E FSHATIT VUTHAJ

Në krahinën e Gucisë dhe të Plavës, në jug të Gucisë, midis maleve të larta (Maleve të Nemuna), shtrihet fshati Vuthaj. Ky fshat zë sipërfaqen (vendin) nga jugu i Gucisë e shtrihet gjer në kufirin me RPS të Shqipërisë.

Kufizohet në tri anë të horizontit-jug, lindje dhe perëndim me Shqipërinë, ndërsa në veri me fushën e Gucisë. Toponimi i fshatit, ai tradicional, është *Vuthaj*. Vendasit quhet *vuthjanë*, ndërsa vendasët *vuthjane*. Të gjithë janë të fisit kelmend.

Në mbështetje të studimit të etimologjisë së toponimit *Vuthaj*, që ia bëri prof. Eqrem Çabej, fshati *Vuthaj* del nga *vuth* që d.m.th: fushë voglake që zgjerohet me prapashtesën — aj. Është më një anë deminutiv me — *th* formuar nga shkalla me *-u* e foljes *vë, vë, vënë* me paskajoren *me vû*, si dhe me mbiemrin participor *i vutë*, në „vend i vutë”.<sup>1</sup>

Disa pleq thonë se emri *Vuthaj* ka dalë nga ajo se fshatarët e fshatit në fjalë „janë vu këtu”, kanë ardhur nga Kelmendi bazë i Shqipërisë.<sup>2</sup> Pra, janë vendosur këtu në këtë luginë të rrafshët për të jetuar, çfarë e vërteton mendimin e shfaqur të prof. E. Çabejt.

Qendrat më të afërta të fshatit të përmendur janë Gucia dhe Plava. Nga Gucia ka largësi prej 1 — 6 km.

Marrëdhëniet tregtare, kulturore e të tjera janë zhvilluar gjer më 1913 me Shkodrën e më rrallë me Pejën. Me mbylljen e kufirit shtetëror me Shqipërinë janë zhvilluar marrëdhënie me Pejën dhe me Qytezat, Plavën e Gucinë. Me këto të fundit janë zhvilluar marrëdhënie tregtare duke u bërë këmbime mallrash sa për nevojat elementare të banorëve të fshatit.

Më përpara rrugët për qendrat: Guci, Plavë, Shkodër dhe Pejë kanë qenë këmbësore, me kuaj, me qerre kuajsh e qesh. Pas Çlirimit janë ndërtuar rrugët automobilistike që lidhin fshatin me Gucinë, me Plavën dhe me Pejën. Që nga viti i kaluar më 1978, kur u adaptua rruga Vuthaj — Guci që lidh fshatin me qendrat e tjera, qarkullon autobusi për nxënësit që ndjekin shkollimin e mesëm në Plavë. Fshatin Vuthaj e rrethojnë majat e

<sup>1</sup> Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore II*. Studime etimologjike në fushë të shqipes, Prishtinë, 1976, f. 308.

<sup>2</sup> Rexhep B. Ahmeti, Musti R. Ahmeti, et të tjerë.

larta të Maleve të Nemuna nga jugu, nga lindja dhe nga perëndimi. Atë e rrethojnë bjeshkët që ngriten mbi fshatrat: Zastan (në jug), Kodra e Liqënit (në jug), Româ (në juglindje), Bjeliç, Qafë e Borit dhe Bori (nga lindja), Komlem (nga perëndimi), Podgojë dhe Bradë (Rogopaç) nga perëndimi.

Fshati Vuthaj përbëhet nga nënfshatrat: *Katuni i Sirum* (nga jugu dhe nga juglindja), *Zaronica* (nga lindja), *Gjonbalajt* (në mes të fshatit qendror), *Gerajt* dhe *Zymerajt* (në perëndim), *Mullië* (në veriperëndim) dhe *Qosajt* (në juglindje).

Ky vend është banuar gjatë sundimit turk nga Kelmendi bazë i Shqipërisë, mirëpo këto territore dhe më gjerë kanë qenë edhe më parë të Kelmendit. Ngulitja e banorëve këtu u bë meqë ky vend ishte pronë e tyre. Në këtë luginë të rrafshët u vendos Gjoni me pesë nipat: Me Dedushin, me Vukën, me Stanishën, dhe me Bruçin. Nipat e Gjoni janë të Nrelit, ndërsa Gjoni dhe Nrelit janë të Balës. Fshati në fjalë ka rreth 200 shtëpi. Vuthjanë ka edhe në Çerem dhe në Valbonë.

Gjer me mbylljen e kufirit me Shqipërinë, marrëdhëniet kulturore dhe martesore janë zhvilluar me Krasniqen, me Gashin, me Shalën, e më vonë, pas mbylljes së kufirit, këto marrëdhënie të përmendura u zhvilluan me fshatrat Martinaj, Hot, Kuj, Pepaj, Arzhanicë, Nokshiq, e më rrallë me boshnjakët e Plavës dhe të Gucisë. Nga këta kanë marrë dhe kanë dhënë vajza, ndërsa nga boshnjakët vetëm kanë marrë, përveç ndonjë rasti të rrallë që kanë dhënë.

Përafërsisht, para 25 vjetësh, martesat kanë zënë të bëhen edhe brenda fshatit (fshatarëve), me përjashtim të familjes flamurtare të fshatit. Këta edhe sot e gjithë ditën e kundërshtojnë një lidhje të këtillë; nuk japin as nuk marrin vajza në fshat, duke konsideruar se ky është veprim i pavend. Për shkak të afrisë së gjakut. Këtë qëndrim e mbajnë ende.

E folmja e vuthjanëve është e ngjashme me atë të martinajve, të hotjanëve të Kujit afër Plavës, të hakajve, të pepajve, të arzhanicasve etj., me gjithë specifikat dalluese që kanë. Vuthjanët e kanë ruajtur gjallë të folmen tradicionale të fisit të të cilit i takojnë, mirëpo kanë kultivuar edhe elemente të reja, bile-bile edhe e kanë pasuruar leksikun e shqipes me fjalë që janë të rralla dhe me rëndësi për gjuhën shqipe në përgjithësi. Meqë me fshatin Martinaj kanë më së shumti marrëdhënie martesore, kulturore e të tjera pasi edhe ata janë të fisit kelmend, e folmja e tyre ka pika të mëdha takimi.

Përveç pjesëtarëve të fisit kelmend, në Vuthaj ka edhe goçaj, të cilët thuhet se kanë jetuar një kohë në krahinën e Plavës dhe të Gucisë e pastaj janë shpërngulur në Peshterë bashkë me të tjerë,<sup>3</sup> e më vonë janë kthyer mbrapa, në Vuthaj. Thuhet se goçajt në fillim të kthyerjes kanë ardhur si muzikantë me tupana, pra kanë qenë tupanxhinj. Bile u ka mbetur edhe mbiemri GOÇ nga druri që godit daullën (si e quajnë vendasit GOÇ).

<sup>3</sup> Andrija Joviçević, *Plavo-Gusinska Oblast, Sez Naselje i Poreklo stanovništva*, knjiga Br. 10, Beograd, 1921, fq. 419.

Mirëpo vendasit i kanë pritur aq mirë sa që edhe u kanë dhënë tokë dhe sot jetojnë si edhe vendasit me të gjitha kushtet.

Shkolla e parë shqipe në Vuthaj është hapur më 1914 ku ka qenë si mësues Josip Vlladoviq Rela nga fshati Arbnesh i Zarës.<sup>4</sup> Më vonë është mbyllur dhe pastaj gjatë regjimit të Jugosllavisë së vjetër mësimi është zhvilluar në gjuhën serbishte pa ndonjë efekt arsimor e edukativ. Pas Çlirimit, LNÇ, është hapur përsëri shkolla shqipe, e cila ka punuar rregullisht.

Ekonomia e fshatit është ajo që u shërben fshatarëve për t'i plotësuar nevojat e tyre jetësore. Janë të zhvilluara degët zejtare, si: murimi, drugdhendja (punimi i mjeteve të punës për blegtori e bujqësi), punimi i kopâjave, i kacave (si e quajnë vendasit zllakopë), i mjeteve për ngrënie, si punimi i bludës, i lugeve etj. Njëkohësisht bëjnë edhe meremetimin e shtëpive nga brenda etj. Këta mjeshtër punojnë edhe jashtë fshatit nëpër vise të Malit të Zi. Shquhen disa fshatarë edhe për aftësinë që kanë në gdhendjen e gurëve të varrezave.

Punëtorët jashtë vendit bëjnë punë sezonale, si muratorë, ndërtues të rrugëve, prerje lëndësh. Mirëpo disa janë shpërngulur edhe jashtë shtetit, në Gjermani, Amerikë, Francë e gjetiu ku qëndrojnë me vite të tëra, disa nga të cilët as që janë kthyer fare.

Ekonomia e fshatit është e përzier. Është e zhvilluar bujqësia dhe blegtoria. Sidomos është e zhvilluar blegtoria me që vendi është i pasur me kullota, më një anë, në anën tjetër toka prodhon mirë vetëm misrin dhe pataten, ndërsa perimet dhe pemët nga pak. Pra blegtoria zë vendin kryesor këtu. Duhet veçuar rëndësinë që ka kjo grykë për zhvillimin e turizmit, sepse vendi është shumë i shëndetshëm dhe ka bukuri natyrore. Mirëpo në këtë drejtim ende nuk është bërë asgjë.

Fshati është i pasur me toponime, të cilat kanë rëndësi të madhe për shkencën e gjuhësisë, për ç'shkak do të shënojmë këtu ato duke u munduar që të gjejmë, me sa kemi mundësi, gjenezën e tyre. Të njëjtat u shërbejnë të tjerëve për të njëjtin qëllim.

Nga treve e Plavës dhe e Gucisë u botua një studim për toponimet e fshatit Martinaj.<sup>5</sup>

Takojmë emra *shtigjesh*, *burimesh*, *lumenjsh*, *përrenjsh*, *kodërash*, *brigjesh*, *kullotash*, *shkëmbinjsh*, *livadhesh*, *shpellash*, *varrezash*, *bjeshkësh*, *qafash*, *mullinjsh* etj.

## 1. Emra shtigjesh (shkallësh)

*Shkalla e mrizeve (j)* — Është një qafë në formë të shkallës prej nga shtrihet një sipërfaqe me kodrina e shkëmbinj që shërben për kullota; njëkohësisht mrizojnë delet nëpër shpella dhe nën drunjt të ulët të këtij

<sup>4</sup> Josip Vlladoviç Rela. *Vepra, bibliografia (parathënie)*. „Rilindja”, Prishtinë, 1971. fq. 9.

<sup>5</sup> Ullai. Idriz. *Toponimia e fshatit Martinaj*. nr. 2. 1979. Titograd (Mars-Prill).

vendi kur bën vapë. Nga këto hije (mrize) është quajtur vendi *Mrize*, meqë ka të tilla mjaft.

*Shkalla e ropojanit (J)* — është në vend kodrinor nëpërmes të të cilit shkon e mbaron një qafë prej nga shtrihet sipërfaqja disa km. me kullota. Pra, kjo pjesë në të dy anët është e ngritur ndërsa në mes është e thellë nga kalon rruga që të shpjerë në drejtim të Shalës.

*Shkalla e Zastanit (J)* — Ndodhet në të hyrë në territorin e bjeshkës së Zastanit. Ka formë po ashtu të shkallës dhe është pjesë e territorit të bjeshkës së përmendur.

*Shkalla e Dorisë (JL)* — Ndodhet në juglindje të fshatit në bjeshkën e Zastanit. Është vend në formë të shkallës nga kalon bagëtia. Mirëpo, një rast paska provuar të kalojë një kalë që e quanin „dori” dhe nuk ia paska arritur qëllimit të kalojë për shkak të terrenit të papërshtatshëm dhe qenka rrëzuar dhe bërë copë-copë. Nga ky rast është quajtur dhe quhet edhe tutje Shkalla e Dorisë.

*Shkalla e Zaronic's (L)* — Kjo formë e vendit ndodhet në territorin e nënfshatit Zaronicë, njëkohësisht është vendi nga shtrihet nënfshati i përmendur. Nëpër këtë shkallë shkohet për në bjeshkët: Fushë e Sirme, Qafë e Borit, Kuj e Kadisë dhe Bjeliç.

*Shkalla e Metbshit (JL)*. — Paska qenë kjo shkallë në territorin e tij — në vendin ku qëndronte bagëtia gjatë pranverës dhe verës, duke ndjekur kullotat. Nuk dihet se kush ishte Metbishi, por mendohet të ketë qenë nga fshati Vuthaj.

*Shkalla e Dhêne (L)*. — Në një territor shkëmbor me shkëmbinj të thepisur ndodhet një shkallë (shteg), ku kapërcejnë me vështirësi delet dhe ku ngjajnë raste që t'u thyhen këmbët. Prandaj është quajtur kështu për atë që u cek më lart.

*Shkalla e Mullinit (JP)*. — Ndodhet pranë mullirit të Selman F. Gjonbalajt dhe për atë shkak quhet Shkalla e Mullinit.

*Shtegu i Românit (JL)*. — Është karakteristike për shumë territore të këtij fshati dhe më gjerë se ato janë të atilla që vështirë është të kapërcehen nga shkak se janë shkëmbore me përbërje të asaj natyre, në të cilat ndodhet ndonjë vend për hyrje apo dalje nga ato, të cilat quhen shtigje. Ky shteg meqë të shpjerë në bjeshkën e Romanit e që mund të hyjë këmbësori edhe delet dhe ngase prej tij fillon territori i bjeshkës së përmendur, quhet Shtegu i Romanit.

*Shtegu i Bjeliçit (L)*. — Është vendkalim prej bjeshkës së Romanit në atë të Bjeliçit që bën pjesë në territorin e Bjeliçit, andaj quhet kështu.

*Shtegu i Qafës Sqapit (L)*. — Në këtë territor (qafë) qëndrojnë shpesh sqeptë e egër, ku ndodhet një pjesë kaluese në formë të shtegut. Në bazë të qafës e ka marrë emrin edhe shtegu i këtij territori shkëmbor vende-vende me kullota.

*Shtegu i Qafës Grishit (JL)*. — Në të hyrë nga pjesa e poshtme në qetën që ishte e individit të quajtur Grish — i, ndodhet një shteg, të cilin e mbyllin fshatarët kur i futin qengjat posa t'i ndajnë nga nënat e tyre (delet).

*Shtegu i Sej's (L).* — Në Qetën e Sejs ndodhet një kalim i vetëm këmbësorësh të shkathët për t'u ngjitur nëpër vende shkëmbore. Meqë ndodhet në këtë territor, dhe është i vetmi vend hyrjeje, aty e quajnë me atë emër. Seja është emër individit (burri) për të cilin thuhet se dihej që ishte vendas.

*Shtegu i Kalit (L).* — Në territorin e brendshëm të bjeshkës së Romanit ndodhet një rrugë kah kalohet me kuaj të ngarkuar, ku me vështirësi kalohej, në të cilin qenka rrëzuar një kalë i ngarkuar me barrë (çakla), nga e ka marrë emrin.

## 2. Emra krojesh (burimesh dhe gurrash)

Ekziston një numër i mirë toponimesh të grupit të shënuar, të cilat i kanë marrë emrat në bazë të vendeve ku ndodhen, të individëve dhe të formës që kanë etj.

*Krojt e Skafkaçit (J).* — Ndodhet një kompleks krojesh (burimesh) që rrjedhin përbri lumit Skafkaç, nga ana e djathtë e rrjedhës së tij, në të cilin edhe derdhen me një sasi të mirë uji.

*Syni i Skafkaçit (J).* — Në mbarim të fshatit, në drejtim të Shalës dhe në veri të Mrizeve, ndodhet burimi në fjalë që ka formë të rrethit, i cili e furnizon dhe e formon lumin Skafkaç. Pjesa që del nga toka është në formë të grykës së kusive. Uji, meqë ka thellësi të madhe i përqendruar në një gropë me thellësi prej 5-6 metrash dhe duket në formë të syrit. për atë shkak është quajtur kështu, si pronë e lumit Skafkaç.

*Kroni i Livadit Palit (L).* — Ndodhet në livadhin e Palit, prandaj i thonë i Livadit Palit.

*Kroni i Rrasave t'Palit (L).* — Edhe ky territor, që ka pamjen e rrasave i përbërë edhe nga shkëmbinj, pronë e Palit, ku ndodhet një krua, është quajtur Kroni i Rrasave të Palit.

*Kroni i Românit (JL).* — Në pjesën e sipërme të Ashtit të Romanit (pyllit të dendur), në të djathtë të Shtegut të Kalit, në të djathtë të rrugës së këmbësorëve që të shpjerë për në bûnë, ndodhet një krua nga rrjedh një sasi fare e vogël e ujit ku zakonisht pushojnë kalimtarët dhe pinë ujë. Pra, ndodhet pranë bunit, rrëzë shkëmbit, në pjesën e sipërme të të cilit shkëmb ndodhet Bûni i Kukajve. Uji është shumë i ftohtë, dhe i pijshëm. Pasi ndodhet në territorin e bjeshkës në fjalë quhet Kroni i Romanit.

*Kroni i Shtegut t'Românit (JL).* — Ndodhet përbri shtegut të vetëm nga mund të kalojnë njerëzit dhe bagëtia për në territorin e bjeshkës së Romanit. Meqë ndodhet në këtë territor, quhet me këtë emër.

*Kroni i Zastanit (JL).* — Ky krua ndodhet në bjeshkën Zastan, i cili i furnizon banorët që dalin të kalojnë verën në këtë bjeshkë. Meqë ndodhet në këtë bjeshkë quhet me këtë emër.

*Koritat Kopâjat e Zastanit (J).* Në pjesën veriore të bjeshkët së Zastanit ndodhen disa liqene që kanë formën e kopâjave ku qitet qumështi

(tamli) për të lëshuar mazën (kajmakun). Këto kanë cilësi edhe të burimeve sepse rrjedhin nga pjesa e poshtme. Pasi kanë formën e kopajave, e të korritave të punuara nga druri, quhen kështu.

*Kroni i Lugut t' Bjeliçit (JL).* — Në territorin e Bjeliçit ndodhet një luginë në të cilën ndodhet një krua, i cili e ka marrë emrin e Luginës në territorin e bjeshkës në të cilën ndodhet, meqë ndodhet aty.

*Kroni i Muratë (L).* — Njëri anëtar i vëllazërisë së Murate nga fshati Vuthaj para se të vdiste paska lënë amanet që të ndërtohet një krua (gurrë), duke lënë një shumë të hollash. Këtë, pasardhësit e tij e kanë ndërtuar dhe nga ai rast e quajnë Kroni i Muratë.

*Krojt (P).* — Rrjedhin nga rrëza e kodrinës së quajtur Sukat që e ndajnë Katunin e Sirum nga Gjonbalajt. Ndodhet një kompleks burimesh. Quhen Krojt meqë rrjedh uji si nga kroi.

*Kusija (JP).* — Përbri lumit Skafkaç ndodhen disa burime, të cilat janë në formë të kusive a të vorbullave. Ky ujë është i pijshëm.

*Kroj e Ali Pashës (JP).* — Në nënfshatin Mullit ndodhet një kompleks burimesh (krojesh) ku e ka pasur vendpushimin dhe pritjen e parisë Ali Pashë Gucia, për ç'shkak i quajnë Kroj e Ali Pashës. Aq shumë ka ujë saqë pa ndërprerje bluajnë dy mullinj. Ky ujë është edhe i pijshëm. Këtë e dëshmon edhe ajo se vetëm e vetëm për të pirë kesi uji dhe për të pushuar, verës shkojnë shumë turistë etj.

*Kroni i Limes (VL).* — Quhet kështu meqë e gjeti individi i quajtur Lime nga familja e Sokol Shpend Qosës. Pra e mori emrin e individit që e gjeti, e zbuloi. Kjo grua mbeti, si thonë vendasit, e pavdekshme.

*Kroni i Rexh's (L).* — Pasi është ndërtuar nga plaku Rexhë e quajnë me emrin e tij.

*Gurra e Ali Met's (L).* — E paska ndërtuar vetë Ali Meta, prandaj e quajnë kështu, me emrin e tij. Kjo u shërben kalimtarëve dhe bagëtisë për të pirë ujë.

*Gurra e Mehmezenelit (VL).* — Tokat e Mehmezenelit e kishin pronë të vetën edhe këtë gurrë, prandaj quhet me këtë emër. Kjo gurrë gjendet pranë rrugës, të cilën e ndërtoi më vonë me vetëkontribut Shaban Rexha-Qosaj nga nënfshati i fshatit Qosaj.

*Gurra e Haxhisë (L).* — E ndërtoi Haxhiu nga fshati Vuthaj për nder të udhëtarëve dhe të vendasve.

*Gurra e Jeftit (P).* — Ishte në territorin ku e kishte tokën individi i quajtur Jeft-i.

*Gurra e Ulë (L).* — Ndodhet në pjesën e sipërme të lagjës Ulaj dhe furnizon me ujë banorët e saj duke përfshirë edhe banorë të lagjeve të tjera të nënfshatit Vuthaj — Katunit të Sirum.

*Gurra e Buzbregut (J).* Ishin disa burime, respektivisht kroje. Vendi ku rridhte dhe rrjedh edhe sot uji ndodhet rrëzë një bregu që vendasit e quajnë Buzbrek që d.m.th. rrëzë, afër bregut. Nëse ndodhen rrëzë këtë bregu quhet kështu.

### 3. Emra lumenjsh dhe përrenjsh (shenash)

Ekziston një numër i konsideruar emërtimesh të përrenjve, të cilat i takojmë me emrin shena, çfarë mendojmë se i përgjigjet mjaft mirë këtij emërtimi duke marrë parasysh anën onomatopeike të ushtimës që e bën uji duke rrjedhur nëpër terrene të rrëpirta, si shshshsh.....

*Skafkaçit (J)*. — Është lumi i vetëm që rrjedh nëpër fshat duke u takuar me përrenj të ndryshëm. Rrjedhën e ka në jug të fshatit në fjalë.

*Vruja (P)* — Formohet nga lumi Skafkaç i cili, i pari, pasi vazhdon të rrjedhë në Gjonbalaj, me të dalë nga Gërlla, merr emrin Gërlla e pastaj Vruja. Vruja bashkohet me ujin e burimeve të Ali Pashës dhe me lumin Dol, dhe pastaj kalon në territorin e Gucisë dhe vazhdon tutje. Mendojmë se toponimi Vruja ka kuptimin e mënyrës së të rrjedhurit të ujit, ushtimës, onomatopeike që e lëshon me këtë kuptim vuuuu etj.

*Puset (VP)*. — Është një përrua (she, si e quajnë vendasit), që rrjedh nëpër lugina malore, me terren të gropuar, që nga jugu shkon e rrjedh në drejtim të fshatit dhe bashkohet me Skafkaçin. Quhet Puse, sepse shtrati i tij nuk është i njëjtë por i bërë puse-puse, ku edhe pasi të shterret uji i tij, nëpër këto gropa të cekëta mbetet ujë.

*Sheu i Mrizeve (J)*. — Meqë rrjedh aty në territorin e Mrizeve, quhet ashtu. Ky she nuk ka ujë verës, përveç pranverës dhe vjeshtës. Në raste të rralla (kur bie shumë shi) edhe verës mban ujë.

*Sheu i Trênt (VP)*. — Buron në vendin e quajtur Kodra dhe shkon e derdhet në burimin Syni. Quhet *i trêntë*, sepse rrjedha e tij nëpër terren të çrregulluar nga shtrati me gurë të mëdhenj gëlqerorë ushton sikur t'ishte i tërbuar kur bien shira të tërbuar dhe kur shkrihet bora në pranverë dhe në vjeshtë. Njëkohësisht rreth e përçark tij është pyll, i cili mban shtazë të egra e më së shumti ujç.

*Sheu i Leskov's (JP)*. — Buron në Luk të Math dhe derdhet në Skafkaç. Quhet i Leskovës sepse ndodhet në territorin e Leskovës.

*Sheu i Bjeliçit (L)*. — Pasi që buron në bjeshkën e Bjeliçit quhet kështu. Ky derdhet në grykën e Gërrlës.

*Sheu i Morrave (i Borit) (L)*. — Quhet Sheu i Morrave sepse kur paska mbretëruar skamje e madhe, banorët përreth tij — ulajt, paskan pasur shumë morra. Për t'u liruar nga ata i paskan hedhur në këtë përrua (she) nga plafat, nga shtrojat dhe nga rrobat e tjera. Nga ai rast quhet kështu. Më parë është quajtur Sheu i Borit meqë rrjedh rrëzë bjeshkës së Borit.

*Sheu i Vogël (L)*. — Për shkak se ka sasi fare të vogël uji quhet Sheu i Vogël. Ky she e ndan përgjysmë një pjesë të fshatit, duke u derdhur në Sheun e Zallit.

*Sheu i Zallit (L)*. — Sheu i Bjeliçit, pasi kalon nëpër territorin e Zallit të Vuthë, e merr emrin Sheu i Zallit, meqë ky territor mban zall.

*Sheu i Ashtit t'Nrekalit (L)*. — Meqë rrjedh nëpër pyllin me lisa dhe drunj të mëdhenj të quajtur Ashti i Nrekalit, është quajtur Sheu i Ashtit

t'Nrekalit. Nrekali ka qenë, sipas të dhënave të vendasve, një banor vendas që e ka pasur këtë regjion të vetin.

*Sheu i Bot's (VP)*. — Pasi që duke rrjedhur kalon nëpër terren që mban tokë të kuqe — botë, quhet Sheu i Bot's.

*Sheu i Crrelit (L)*. — Meqë sasia e ujit të këtij sheu zakonisht është e vogël dhe pasi hidhet nga lartësia e madhe në formë të currilit, quhet Sheu i Crrelit (pra në formë dhe sasi të currilit).

*Sheu i Hok's (JL)*. — Buron në tokën, pronar i së cilës ishte individi i quajtur Hokë.

*Sheu i Azlla Çel's (JP)*. — Meqë shpeshherë ky she e ka vërshuar tokën e mbjellë dhe livadhin e Asllanit, është ruajtur me këtë emër. Asllani ishte i çelajve nga fshati Vuthaj.

#### 4. Emra kodrash

*Kodra e Ropojanit (J)* — Është vend me kullota dhe pjesërisht i pyllëzuar. Pasi janë pronë e territorit të Ropojanit e quajnë me emrin e shënuar.

*Kodra e Zharit (J)*. — Është kodër që dikur ka qenë djegur e bërë si thonë vendasit, ZHAR, pluhur e hi. Nga ky rast quhet Kodra e Zharit.

*Kodra e Bûnit t'Paunit (J)*. — Kjo kodër ndodhet në territorin e bunit ku ka qëndruar verës personi i quajtur Paun. Nuk dihet se kush ishte ai, por mendohet se ishte vendas.

*Kûji i Breshnit (L)*: — Është vend kodrinor, i ngritur në formë të kujit, ku bie shpesh breshër. Ndodhet në territorin e bjeshkës së Bjeliçit.

*Kodra e Këlbaz's (L)*. — Sipas thënieve të pleqve, në këtë kodër, në kohët e mëparme i kanë kullotur delet vendasit dhe janë kujdesur që mos t'u këlbazen meqë nuk kanë disponuar medikamente për t'i shëruar. Si thotë rrëfyesi, Sokol Shpendi nga nënfshati Qosaj „nuk kanë pa dalë kokrrat kundër këlbazës”. Disa të tjerë shtojnë se në këtë territor rritet bari i këlbazës, prej të cilit i kanë ruajtur delet etj.

*Kûji i Kadis (L)*. — Është vend — bûnë ku dalin verës fshatarët për t'i kullotur bagëtitë. Ky vend ka formën e kûjit — kodrës së mprehtë. Thuhet se paska dalë më parë kështu verës një kadi, por nuk dihet kush dhe nga ishte, nga i cili e quajten kështu dhe e quajnë edhe sot e gjithë ditën.

*Kodra e Liqênit (J)*. — Ndodhet në afërsi të kufirit me RPS të Shqipërisë, në vazhdim të të cilit, nga jugu, shtrihet Liqeni i Shtarës. Në bazë të liqenit në fjalë quhet Kodra e Liqenit. Përfshin një sipërfaqe të madhe kullotash, ku më përpara ishte bjeshkë e veçantë, ku dilnin për t'i kullotur bagëtitë familje të tëra gjatë verës.

## 5. Emra brigjesh

Këto zakonisht janë kullota të mira që shtrihen nëpër bjeshkë të ndryshme.

*Bregu i Românit (JL).* — Është territor me sipërfaqe të madhe. Ndodhet në bjeshkën e Romanit, pronë e vëllazërisë Ahmetaj nga fshati Vuthaj, të cilët dalin verës me bagëti për të kaluar këtë stinë dhe për të mbledhur bulmet. Në të mund të kullotin me qindra dele, lopë, kuaj etj.

*Bregu i Malsores (L).* — Është një sipërfaqe në formë të bregut. Thuhet nga vendasit se për të parën herë paska zënë vend verës një malësore, në bazë të së cilës e paska marrë dhe emrin Bregu i Malsores. Ndodhet në bjeshkën e Bjeliçit. Malësorja qenka vendosur këtu duke ndërtuar edhe tëbana (dbane). Ka sipërfaqe prej disa kilometrash.

*Bregu i Gurrave (L).* — Ndodhet në territorin ku gjenden disa gurra, nga edhe e ka marrë këtë emër. Më përpara (heret) ky breg është quajtur, shtojnë rrëfyesit, BREGU.

*Bregu i Vocit (L).* — Voci paska qenë pronar i këtij kompleksi livadhesh (i këtij bregu), për ç'shkak e quajnë kështu. Nuk dihet kush dhe nga ishte ai, por mendohet të ketë qenë banor vendas. Ky breg ndodhet në bjeshkën e Borit.

*Bregu i Love (JL).* — Meqë është vend i përshtatshëm ku edhe qëndrojnë kohën më të gjatë lopët verës, u quajt Bregu i Love.

*Bregu i Kollat's (L).* — Ndodhet në majën e quajtur Kollatë, në bjeshkën e Qafës së Borit.

*Bregu i Çobane (P)* — E quajnë kështu sepse çobanët (barinjtë) qëndronin shpesh në të ku luanin e bisedonin për probleme të ndryshme që i preokuponin ata.

*Bregu i Muko Ibr's (P).* — Në këtë breg paska qëndruar një kohë të gjatë individ i në fjalë me bagëti etj., prandaj e quajtën kështu. Nuk dihet se kusht ishte, mirëpo mendohet të ketë qenë nga fshati.

*Bregu i Nestrashes (P).* — Mendohet se Nestrasha ishte pronar i këtij regjioni, prandaj e ka marrë edhe emrin e tij.

*Bregu i Lulashit (L).* — Ky breg thuhet se ishte pronë e Lulashit, e një individ, për të cilin nuk dihet se nga ishte as kush ishte

*Bregu i Bal's (L).* — Paska qenë ky vend i Balës, i një banori të hershëm të fshatit Vuthaj. Bala në këtë breg paska pushuar shpesh me nipat e vet. Ndodhet nën majën e Qarrishtës.

*Bregu i Shelin's (VP).* — Shtrihet në pjesën perëndimore të nënfshatit Vuthaj, Geraj. Meqë përveç bimëve të tjera rritet edhe shelgu, atë e quajtën SHELINË, në bazë të bimës.

*Bregu i Pajisht's (VP).* — Pasi që ndodhet në vendin ku rritet me të madhe druni PAJË-A, e quajtën kështu.

*Bregu i Druve (P).* — Fshatarët në këtë breg presin drurë shpesh dhe këtu pushojnë para dhe pasi ta kryejnë këtë punë. Meqë është vend në formë bregu, i pasur me drurë, e quajnë me këtë emër. Këta drurë i shfrytëzojnë vetëm për ngrohje.

*Bregu i Bridashes (L)*. — Në territorin e një brinje të pronares së grupas së quajtur dikur DASHE ndodhet ky breg, në bazë të së cilës është quajtur kështu. Mbahet mend të ketë pasur emër burri DASH, prandaj mund të mendohet se edhe ky emër femre të ketë ekzistuar.

## 6. Emra shkëmbinjsh (gurësh)

*Maja e Pajisht's (VP)*. — Meqë rrëzë saj ndodhet vendi i quajtur Pajishtë, është quajtur kështu. Njëkohësisht kjo majë bën pjesë në territorin e përmendur.

*Maja e Qarrisht's (L)*. — Ndodhet mbi vendin e quajtur Qarrishtë, nga i cili e ka marrë atë emër.

*Maja e Vajzës (JL)*. — Sipas legjendës së krijuar për këtë majë, që bën pjesë në territorin e bjeshkës së Romanit, nga vendasit është quajtur Maja e Vajzës (vajs), sepse një vajzë malësore duke ruajtur bagëtinë në Breg të Romanit, paska qenë në rrezik të çnderohet nga një „harap” mirëpo ajo paska kundërshtuar bile, paska pranuar të vdesë e atë gjë mos ta pësojë. Për atë shkak, duke mos pasur rrugëdalje tjetër, ka hipur në këtë majë dhe është hedhur poshtë duke u bërë copë-copë. Vazhdojnë rrëfyesit, kokrra e arrës të cilën e paska pasur në dorë i ka rënë poshtë në zall dhe bashkë me të ka rënë edhe vetë. Sot, rrëzë asaj maje ndodhet një dru arre, e cila është e vetmja e këtij lloji në këtë territor, çfarë mund të besohet. Nga ky rast, kur vajza e fisit në fjalë, flijoj jetën dhe shpëtoi nderin e vet dhe të familjes, kjo majë u quajt Maja e Vajzës.

*Maja e Borit (L)*. — Ndodhet në bjeshkën e Borit, në bazë të së cilës quhet me këtë emër.

*Maja e Rosit (JL)*. — Ndodhet mu në kufi me RPS të Shqipërisë. Bën pjesë në territorin e bjeshkës së Romanit përveç një pjese të Valbonës etj.

*Maja e Karajfilit (JË)*. — Është quajtur kështu sepse rritet shumë lulja karanfili.

*Maja e Brad's (Rokopeçit) (VP)*. — Ndodhet në territorin e bjeshkës së Bradës. Nuk dihet pse quhet kështu.

*Maja e Çame (P)*. — Është e ndarë përgjysmë, e çarë, si thonë vendasit. Nëpërmes të saj kalojnë kafshët dhe njerëzit.

*Maja e Komlemit (VP)*. — Ndodhet e ngritur në bjeshkën e Komlemit.

*Maja e Podgoj's (VP)*. — Ndodhet e ngritur në bjeshkën e Podgojës.

*Maja e Alisë (JL)*. — Meqë bënte pjesë në territorin e individit të quajtur Ali, e quajnë kështu.

*Maja e Rrasave (JL)*. — Midis Romait dhe Zastanit, pranë kufirit me RPS të Shqipërisë ndodhet kjo majë, në të cilën në formë rrathësh duken rrasat në të. Në bazë të këtyre rrasave që kanë formë teracash, quhet maja e Rrasave.

*Maja e Madhe (L).* — Në pjesën e sipërme të Bunit të Bjeliçit ndodhet kjo majë, e cila përka madhësia dallohet nga të tjerat në këtë anë, prandaj quhet Maja e Madhe.

*Maja e Fazlis (VL).* — Tokat e pasura me kullota, ku ndodhet edhe maja, ishin të personit të quajtur Fazli. Nuk dihet kush ishte ai as nga ishte, por mendohet të këtë qenë nga ky fshat.

*Maja e Kollat's (L).* — Ndodhet në territorin e bjeshkës së Qafës së Borit. Nuk dihet nga ka dalë emri Kollatë.

*Maja e Kol's (L).* — Quhet territori rreth e përqark kësaj maje, duke e përfshirë edhe ishtin, pronën e individit të quajtur Kolë. Nuk dihet nga ishte dhe kur e ku jetoi.

*Maja e Shtjerrave (L).* — Meqë një numër i madh qengjash (shtjerrash, si i quajnë vendasit) kanë qëndruar dhe qëndrojnë aty herë me barinj e herë pa ta, është quajtur kështu.

*Maja e Nikë (L).* — Kjo majë paska qenë pronë e një barku të quajtur NIKAJ, nga e cila majë qenka rrëzuar vetë Nika. Për këtë shkak e quajnë kështu.

*Maja e Qytezës (L).* — Ndodhet një livadh midis shkëmbinjve që ka formën e qytetit brenda kalasë. Ky është shkaku që e quajnë kështu.

*Guri i Avlis.* — I pari i fshatit, Gjoni, e kishte shtëpinë pranë një guri, i cili dikur ishte i vendosur në avllinë e tij.

*Shkâmi i Mur's (P).* — Rreth e përqark një shkëmbi, në të tri anët e tij, kishte ekzistuar një mur. Pra e kanë quajtur Shkâmi i Murës nga ajo që ai shkëmb është i murit.

*Shkâmi i Kuq (P).* — Ndodhet në rrathët e Bletës. Meqë ka ngjyrë të kuqe, e quajnë kështu.

*Shkâmi i Salihit (L).* — Banori i fshatit Vuthaj, Salih Rrustemi, paska shkuar në këtë shkëmb për të prerë drurë dhe qenka rrëzuar. Nga ai rast e quajnë me emrin e tij.

*Shkâmi i Mustaf's (L).* — Mustafë Arifi nga fshati Vuthaj qenka rrëzuar nga ky shkëmb, por paska shpëtuar nga vdekja.

*Shkâmi i Blet's (P).* — Në këtë shkëmb ka bletë dhe për atë arsye e quajnë me këtë emër.

*Shkâmi i Baknik's (P).* — Baknika ishte pronar i tokave dhe i majës në të cilën gjendet ky shkëmb. Thuhet se ky individ ishte vendas.

*Guri i Bot's (P).* — Është i shkrifët me ngjyrë të kuqe.

*Shkrepi i Zi (JL).* — Fjala shkrep ka kuptimin e shkëmbit me madhësi më të vogël se shkëmbi, por që është i thepisur. Meqë ky gur është me ngjyrë të zezë, quhet i zi.

*Guri i Românit (L).* — Në një rogë, pranë rrugës së Kalit, që të shpjerë në bjeshkën e Romanit, ndodhet një gur, nga fillon edhe territori i kësaj bjeshke nga ajo anë.

*Guri i Math (JP).* — Është më i madh se gurët e tjerë në terrenin e vet të ngushtë. Ndodhet afër Gërrlës.

*Guri i Sahatit (L).* — Ndodhet nën majën e bjeshkës së Borit. Quhet Guri i Sahatit, sepse kur arrin hija gjer te ai gur, gjer në mbremje mbetet edhe një orë (si thonë vendasit: „Kur mrrin hieja te Guri i Sahatit, metet edhe i sahat ditë”).

*Gurt e Mdhej (P).* — Ndodhet në një territor të ngushtë një kompleks gurësh të mëdhenj.

*Guri i G-jatë (JL).* — Është një gur i lartë midis malit.

*Gurt e Zenunit (JL).* — Ishte vend i individit të quajtur Zenun nga fshati Vuthaj.

*Gurt e Imerit (JL).* — Ky vend, në të cilin ndodhen këta gurë, ishte i Imerit, i një banori të fshatit.

*Kâma e Keqit (P).* — Në mes të një rrase ndodhen disa plasa, në njërin nga të cilat e paska thyer këmbën individi i quajtur KEQ-I. Nga ai rast ky vend quhet Kâma e Keqit. Thuhet se ajo plasë e ka formën e këmbës së njeriut.

*Rrathit e Blet's (P).* — Është shkëmb me pamje gjysmërrathësh, pranë të cilit ndodhet një shpellë ku ka bletë (shpella e Bletës). Prandaj quhet Rrathit e Blet's.

*Rrasat e Românit (JL).* — Në territorin e bjeshkës së Romanit ndodhet një kompleks rrasash, të cilat i quajnë Rrasat e Romanit.

*Kërshi i Qose (L).* — Në territorin e Qosajve (nënfshatit) të fshatit Vuthaj, në jug, ndodhet një sipërfaqe e cila është e pasur me kullota. Kërshi ka kuptimin e shkëmbit.

*Kërshi i Sherifit (J).* — Ndodhet një shkëmb, si e quajnë ndonjëherë vendasit „kerrsh”, në livadhin e individit të quajtur Sherif T. Ahmetaj. Në bazë të emrit të pronarit e quajnë me atë emër.

*Kërshat e Çam (L).* — Është një territor në vendin Mërmatânë, me livadhe etj. ku ka shumë shkëmbinj të çarë.

*Kërshi i Zaronic's (L).* — Ndodhet në territorin e Zaronicës.

*Skribat e Bregut të Romanit (JL).* — Në territorin e Bregut të Romanit ndodhet një pjesë e pasur me kullota, ku ka shkëmbinj të ulët e të thepisur. Përbri tyre ka edhe bar, të cilin e kullot bagëtia.

*Skribat e Qaf's Borit (L).* — Në bjeshkën e Borit ndodhet një vend ku ka shkëmbinj të ulët e të thepisur, rreth e përçark të të cilëve rritet bari kukullot bagëtia. Nuk dihet pse e quajnë skriba.

## 7. Emra shpellash

*Shpella e Birueme (P)* — Ka thellësi prej afër 5 m. dhe ka dy hyrje. Meqë hyrja ka formën e vrimës (birës), quhet shpella e Birueme.

*Bira e Ropojanit (JL).* — Në territorin e Ropojanit, në pjesën jugperëndimore ndodhet një shpellë, e cila nga larg duket në formë vrime (bire, si thonë vendasit). Ajo shpellë u ka shërbyer shumë barinjve gjatë vjeshtës dhe pranverës për t'u strehuar nga shiu e të ftohtit.

*Shpella e Kuqe (JP)*. — Meqë rreth e përqark dhe brenda shpellës (shkëmbit) ka ngjyrë të kuqe të çelët, e quajnë shpella e Kuqe.

*Shpella e Palit (L)*. — Ndodhet në territorin e pasurisë së patundshme të individit të quajtur Pal, nga e ka marrë emrin e tij edhe shpella.

*Shpella e Dhive (P)*. — Kanë qëndruar shpeshherë barijtë me dhi në këtë shpellë, nga edhe e quajnë kështu.

*Shpella e Madhe (L)*. — Meqë për kah madhësia kjo shpellë dallohet nga të tjerat, quhet Shpella e Madhe. Ndodhet në pjesën e sipërme të Zhareve të Mërmatanës.

*Shpella e Mar's (JP)*. — Baresha e quajtur Marë paska qëndruar në këtë shpellë shumë vera etj.

*Shpella e Murrik's (L)* — Që nga rasti kur qenka rrëzuar e rënë në këtë shpellë një lopë e quajtur MURRIKË, e quajnë kështu.

*Shpella e Erës (L)*. — Te kjo shpellë thuhet se fryn erë shumë e ftohtë dhe e fortë sa që edhe verës ndihet freski (të ftohtë). Nga ky shkak që fryn erë e madhe, quhet me këtë emër.

*Shpella e Kopâjave (L)*. — Meqë shpella në fjalë qenka e përshtatshme për t'i strehuar gjërat dimrit, banorët e fshatit për të mos i bartur me vete në vërri, përveç gjërave të tjera, kopâjat, i kanë vendosur në këtë shpellë dhe kështu i kanë shfrytëzuar verave të tjera. Për shkak të vendosjes së kopajave këtu quhet Shpella e Kopâjave.

*Shpella e Gabelve (L)*. — Thuhet se dikur qenkan strehuar në këtë shpellë disa jevgj, që vendasit i quajnë GABEL. Nga ajo kohë e quajten shpellën kështu.

*Shpella e Sokol Avdis (L)*. — Jo larg bjeshkës së Qafës së Borit ndodhet një shpellë, në të cilën qenka strehuar me dele bariu i shquar në këtë anë, Sokol Avdi Brunçaj, i njohur edhe si këngëtar. Është nga fshati Vuthaj.

*Shpella e Ropojanit (J)*. — Në bjeshkën Ropojan, vend i dalluar me kullota, ndodhen disa shpella, të cilat quhen me emrin e vetë vendit ku ndodhen.

*Shpella e Taf's (L)*. — Në mbarim të vjeshtës paska qëndruar shpesh dhe një kohë të gjatë bariu, Tafë Haxhi Vuçetaj me dele, emrin e të cilit e mori edhe shpella. Ky individ është nga fshati Vuthaj.

*Shpella e Kollit (P)*. — Ndodhet afër mullirit të Selman Fazli Gjonbalajt, në të cilën ka ujë në një thellësi prej 2 m. Quhet Shpella e Kollit, sepse sipas legjendës, fëmijët që kolliteshin, i çonin në atë shpellë dhe i sillnin tri herë në të, duke dalë dhe hyrë nga ajo, me ç'rast i hedhnin nga disa para të imta, duke menduar se fëmija do të pushonte së kollituri.

*Shpella e Bregut t'Romanit (L)*. — Ndodhet në jug të Bregut të Romanit, në të cilën ka borë aqë shumë dhe pozita e shpellës është e atillë që bora qëndron përherë.

*Shpella e Blet's (P)*. — Meqë ka shumë bletë në të, e kanë quajtur kështu.

*Shpella e Ujit (P)*. — Ndodhet në shpinën e Majës së Pajishtës. Në të ka ujë gjatë të gjitha stinëve të vitit.

*Shpella e Zastanit (JL)*. — Ndodhet në bjeshkën e Zastanit.

*Shpella e Korun's (I)*. — Ndodhet në territorin e bjeshkës së Bjeliçit. Njëkohësisht është në kufi me bjeshkën e Romanit.

## 8. Emra luginash

*Lugu i Bjeliçit (L)* — Ndodhet në territorin e bjeshkës së Bjeliçit. Njëkohësisht është në kufi me bjeshkën e Romait.

*Lugu i Maj's Vajs (vajzës) (L)*. — Pranë Majës së Vajzës ndodhet kjo luginë, prandaj quhet Lugu i Majës Vajzës (Vajs).

*Lugu i Vogël (JL)*. — Shikuar nga sipërfaqja, është më i vogël se sa luginat e tjera. Për këtë shkak quhet Lugu i Vogël.

*Lugu i Vukë (L)*. — Ishte një pronë livadhesh e banorëve të quajtur nga fshatarët — Vukaj.

*Vija e Marës (JP)*. — Ndodhet në perëndim të Gjollave të Zastanit. Quhet kështu se përbri kësaj lugine ndodhet një shpellë në formë të vijës, ku kishte qëndruar një malësore me dele e quajtur Marë.

*Zgërlyqi (P)*. — Është luginë që shtrihet në perëndim të fshatit dhe lidh nënfshatrat, Katunin e sirum dhe Gjonbalajt. Meqë duke kaluar kënde (nëpër atë luginë), nëpër të cilën ndodhen çufrra, guraleca etj., dëgjohet krismë. Pra nga këta tinguj onomatopeikë quhet kështu.

*Lugu i Mânes (L)*. — Në Lagjen Vuçetaj paska jetuar një grua e quajtur Mane, e cila e paska pasur pronë të vetën këtë luginë.

*Lugu i Shkrelë (L)*. — Paska qenë pronë e banorëve të quajtur Shkrelaj. *Lugu i Mânja (L)*. — Ka pasur shumë mana nga të cilët, e ka marrë këtë emër.

*Lugu i Çelë (L)*. — Ndodhet në pronën e banorëve të fshatit të quajtur Çelaj.

*Lugu i Dimnit (L)*. — Meqë kurdoherë bën ftohtë, bile edhe verës, quhet me këtë emër.

*Lugu i Românit (L)*. — Ndodhet në bjeshkën e Românit.

*Lugu i Math (JP)*. — Pasi përkah madhësia nga luginat e tjera dallohet në këtë anë, quhet kështu.

*Lugu i Shtrëmt (VL)*. — Pasi ka formë të shtrembër quhet Lugu i Shtrëmt.

*Lugu i Vjetave (L)*. — Afër Bunit të Bjeliçit ndodhet një luginë, ku kullotin zakonisht viçat.

*Luginat e Lazmazoreve (L)*. — Është vend ku zakonisht qëndronin „shterpat” (qengjat dhe rrunxat), për të cilat kujdesej bariu. Mirëpo, me këto „shterpa” kishte edhe disa dele me qumështin e të cilave ushqehet

bariu. Kjo përzierje e „shterpave” me dele quhet LAZMAZORE. Fjala *Lazmazore* mendoj se del nga fjala *lasmas*, që d.m.th. përzierje e hirrës së zënë si kos me pak qumësht (tamël). Pra këtë përzierje vendasit e quajnë LASMAS. E pasi kemi edhe në bagëtinë një përzierje të këtillë, e quajnë Lazmazore.

*Lugu i Arush's*. — Ishte çerdhe arinjsh, që vendasit i quajnë arusha.

*Lugu i Kuq (L)*. — Përbërja e tokës ka pamje të kuqe (nga bota).

*Lugu i Përsllupit (L)*. — Bën ndonjëherë vapë aq e madhe saqë të përcëllon. Mendojmë se nga kjo del edhe fjala PËRSLLOP.

*Lugu i Kollat's (L)*. — Ndodhet në bjeshkën e Qafës së Borit.

## 9. Emra qetash

*Qeta e Grishit*. — Ishte pronë e individit të quajtur Grish. Nuk dihet nga ishte dhe kur jetoi, por mendohet të ketë jetuar këtu, në fshat.

*Qetat e Dregz's (JL)*. — Kjo qetë ka pozitë mjaft të rrëpirët me pamje të dregzës. Sipas të dhënave të vendasve thuhet se del nga fjala dregëz.

*Qetat e Livadit t'Palit (L)*. — Janë të pronës së Livadhit të Palit.

*Qetat e Bregut t'Românit (JL)*. — Janë pronë e bjeshkës dhe Bregut të Romanit.

*Qetat e Aligjonit (JL)*. — Ishin pronë e individit të quajtur Ali Gjoni, të cilat i shfrytëzonte duke i kullotur me dhi dhe duke ua marrë sanën.

*Qetat e Hyskurtit (JL)*. — Ishin pronë e individit të quajtur Hysen Kurti nga fshati Vuthaj.

*Qeta e Viçq (JL)*. — Thuhet se vendoseshin viçat këtu ditën, meqë ishte vend i përshtatshëm për ta.

*Qeta e Sjapit (JL)*. — Shpeshherë shihen cjep të egër duke kullotur dhe qëndruar këtu.

*Qetat e Pajës (JL)*. — Në këtë qetë ka shumë drunj paje.

*Qeta e Djegune (JL)*. — Qenka djegur bari dhe drunj të saj.

*Qeta e Madhe (L)*. — Është më e madhe nga ato që ndodhen në këtë anë.

*Qeta e Shneprënës (JL) dhe Qeta e Shkurtanit (JP)*. — Ishin prona të individit të quajtur Shkurtan.

*Qeta e Mllezës (JL)*. — Rritet shumë druri i quajtur MLLEZË.

*Qetat e Borit (L)*. — Janë prona dhe ndodhen në bjeshkën e Borit.

*Qeta e Sej's (JL)*. — Quhet kështu sipas emrit të një banori.

## 10. Emra urash

*Ura e Leskov's (JP)*. — Ndodhet mbi lumin SKAFKAÇ që bën pjesë në vendin e quajtur Leskovë. Njëkohësisht është pronë e këtij vendi.

*Ura e Mehucit (Merhucit) (L).* — Ishte në pronën e individit të quajtur *Mehë*, emër ky që me siguri do të ketë dalë nga emri *Mehmet*, ku janë bërë ndryshime në *Mehë* duke ia shtuar edhe prapashtesën-*uc*.

*Ura e Gurit (J).* — Është një rrasë e trashë rreth 60-80 cm., që shërben për të kaluar ujin njerëzit dhe kafshët.

*Ura e Gjoralë (L).* — Pasi që ndodhet në nënfshatin në fjalë — Gjonbalaj dhe, njëkohësisht është edhe pronë e tyre, quhet kështu.

*Ura e Vruj's (V).* — Është e vendosur mbi lumin Vrujë, rreth e përqark të së cilës shtrihen livadhet e Vrujës.

*Ura e Gërrl's (JP).* — Ndodhet mbi ujvaren e Gërrlës.

### 11. Emra mullinjsh

*Mullini i Laldemë (L).* — Është pronë e individit, Lal Dema Goçaj, të cilin e ndërtoi për të bluar drithërat që i nevojiteshmi për vete dhe për vëllezërit.

*Mullini i Selmâ Fazlisë (P).* — E ndërtoi individi i quajtur Selmân Fazli Gjonbalaj.

*Millini i Kukë (J).* — Është pronë e vëllazërisë Kukaj.

*Mullini i Selman Shpënit (VP).* — Është pronë e Selmanit, të cilin edhe e ndërtoi vetë për interesa personale.

*Mullini i Ali Him's (JP).* — E ndërtoi ai vetë për ta mbajtur familjen me ujemin e fituar. Fjala është për Ali Himë Ahmetajn.

### 12. Emra varrezash

*Vorret e Katunit (J).* — Janë varreza ku varrosen banorët e nënfshatit, ata të Katunit të Sirum.

*Vorret e Ahmetë (J).* — Ndodhen në Suka. Këtu janë varrosur më heret vetëm të vdekurit e vëllazërisë Ahmetaj, prandaj edhe quhen kështu.

*Vorret e Dedushë (J).* — Në vendin e quajtur *Shtrejt*, që është vend i ngushtë (një kalesë e ngushtë midis livadheve edhe malit), në të cilin u pushkatuan dy burra të vëllazërisë Dedushaj.

*Vorret Reç (J).* — Janë varrezat ku u varrosën shumë të vrarë që ishin Reçjanë nga Shqipëria.

*Vorret e Gjoralë (J).* — Janë prona dhe varrosen të vdekurit e këtij nënfshati të fshatit Vuthaj.

*Vorret e Mehmetë (P).* — Ndodhen në Geraj, ku varrosen vetëm të vdekurit e vëllazërisë Mehmeti.

*Vorret e Qosë (L).* — Janë të Qosajve ku i varrosin të vdekurit e tyre.

### 13. Emra gropash

*Gropat e Qelanê (L)*. — Paska qenë pronar i këtyre gropave një individ qelan, që e kanë trashëguar edhe të afërmit e tij.

*Gropat e Ulê (JL)*. — Në bazë të bjeshkës së Romanit ndodhen dy grupa: Gropa e Poshtme dhe Gropa e Sirme, prona të vëllazërisë Ulaj.

*Gropa e Ahmetê (JL)*. — Po ashtu në bjeshkën e Romanit ndodhet një kompleks gropash. Meqë janë prona të vëllazërisë Ahmetaj, quhen kështu.

*Gropa e Bor's (JL)*. — Në bjeshkën e Zastanit ndodhet një gropë ku qëndron një kohë të gjatë bora pa u shkrirë.

*Gropat e Kukê (J)*. — Janë livadhe të vëllazërisë Kukaj

### 14. Emërtime të tjera të ndryshme

*Ashta e Bjeliçit (L)*. — Është pyll i dendur me lisa të gjatë dhe të trashë.

*Ashta e Românit (JL)*. — Po ashtu është pyll i dendur me drunj të trashë dhe të gjatë (të lartë).

*Rogat e Ashtit t' Bjeliçit (L)*. — Midis pyllit ndodhen sipërfaqe të papyllëzuara në formë rogash, ku ka kullota të varfëra.

*Roga e Ashtit të Românit (JL)*. — Ndodhet mu në rrugë që të shpjerë për në bjeshkën e Romanit një zbrazëti midis pyllit.

*Bûni i Bjeliçit (L)* — Është një vend ku vendosen bjeshkatarët e fshatit nëpër tëbana verës me bagëti. Meqë ndodhet në bjeshkën e quajtur Bjeliç, atëherë e ka marrë këtë emër.

*Gjollat e Bjeliçit (L)*. — Në të hyrë në territorin e Bjeliçit, pranë Zaronicës ndodhet një kompleks gjolas ku u qitnin nëpër gurë e rrasa deleve kripë. Ky territor njëkohësisht është pjesërisht i pyllëzuar e pjesërisht i zhveshur gjolla-gjolla.

*Bûni i Shtjerrave (JL)* — Është një vend i përshtatshëm për qëndrimin e qengjave ku edhe vendoseshin më parë për të kaluar natën. Prandaj quhet Buni i Shtjerrave. Ndodhet në Bregun e Romanit

*Shtrêjti (L)*. — Midis nënfshatrave Gjonbalaj dhe Qosaj ndodhet një ngushticë kah kalon rruga e quajtur *Shtrejt*. Fjala *shtrejt* në këtë anë përdoret në end të *ngushtë*.

*Pajishta (JP)*. — Është një vend me kullota, në të cilin rritet druri i quajtur PAJË, nga i cili është quajtur kështu.

*Ara e Pajisht's (JP)*. — Në vendin e quajtur PAJISHTË ndodhet një vend ku mbillnin vendasit patate, thekër, elb, etj. Prandaj i ka mbetur emri Ara e Pajishtës.

*Potet (P)*. — Ndodhet një kompleks terracash, të cilat quhen POTE.

*Rrath e Gere (P)*. — Në pjesën e sipërme të nënfshatit Geraj ndodhet një terren i tillë shtatijesh që kanë pamjen e rrathëve.

*Leskova (JP)*. — ishte dikur një vendbanim i vëllazërisë Ulaj dhe Çelaj, që sot shërben për kullota dhe ka një numër të madh livadhesh e arash.

*Pllana e Sylo Ruçit (JP)*. — Rrëzë Borit ndodhet kjo Pllanë — livadh, pronë e një fshatari të quajtur Syl Oruç Çelaj.

*Fushat (J)*. — Përfshin një kompleks arash të mbjella.

*Gërrla e Borës (JP)*. — Është një kanjon shkëmbor ku rrëshqet bora nga lartësi të mëdha dhe e gërryen shkëmbin gëlqeror. Mendojmë se nga gërryerja quhet *gërrol*.

*Fytet (JL)*. — Ndodhet një sipërfaqe e rrëpirët, e pyllëzuar, aty-këtu shkëmbore që ka formë jo të rrafshët, që i ngjan fytit. Prandaj quhet FYTE.

*Roga e Fyteve (JL)*. — Ndodhen disa pjesë të vogla të papyllëzuara nëpër këtë terren.

*Rrasat e Zastanit (JL)*. — Në pjesën veriore të Zastanit ndodhet një kompleks rrasash.

*Zabeli i Ujka Smajlê (VL)*. — Është bjeshkë ku dilnin anëtarët e familjes së individit, Ujkan Smajl Ahmetajt. Është vend i pasur me kullota.

*Gjollat e Zastanit (J)*. — Është bjeshkë ku dilnin anëtarët e familjes Zastan. Është pjesë e pasur me kullota, ku pjesë — pjesë është e pyllëzuar e vende-vende e papyllëzuar.

*Gjolla e Fell (JP)*. — Midis pyllit, në fund të Lugut të Math dhe të Puseve të Ropojanit ndodhet një vend i papyllëzuar, i thellë, me një ultësi më të madhe se pjesët që e rrethojnë. Për këtë shkak quhet e thellë e (fellë).

*Runxat e Brad's Vezirit (VP)*. — Janë disa sipërfaqe të vogla që lidhen me lartësi malore, të cilat quhen rrânxa.

*Buzat e Bjeliçit (L)*. — Këto janë qeta dhe pjesë të tjera shkëmbore, me kullota etj., të cilat quhen edhe Rrânxat e Bjeliçit. Pra *rranxa* dhe *buza* janë shprehje të ngjashme. Quhen *buza* sepse janë afër (si thonë vendasit *buz Bjeliçit*).

*Mullit (VP)*. — Është nënfshat i fshatit Vuthaj. Meqë ndodhen katër shtëpi nga ato të dy mullinjve, quhet Mullit. Ndodhet pranë Krojeve të Ali Pashë Gucisë, të cilët i furnizojnë me ujë.

*Rrasat e Leskov's (JP)*. — Disa pjesë të shkëmbinjve janë në formë të rrasave, të lëmueshme. Meqë ndodhen në territorin e Leskovës i quajnë kështu.

*Rrasat e Kuqe (JP)*. — Shkëmbinjtë e rrafshët kanë pamje të kuqe, prandaj i quajtën kështu.

*Liqëni i Shtar's (J)*. — Meqë rreth e përqark tij rritet bima e quajtur SHTARË, e mori këtë emër dhe liqeni.

*Vllaçegu i Ahmetê (JL)*. — Vllaçe-vllaçe, ose më mirë të themi tuba-tuba drunj të dimrit i tërheqin zakonisht nëpër vend të rrëpirët gjer afër shtëpisë. Meqë këta drunj në tokë e kryejnë punën sikurse vllaça në arë, është quajtur Vllaçeg. Vendi kah tërhiqen drunj të quhet VLLAÇEG.

*Vllaçegu i Sadrijê (JL).* — Në këtë territor, të pyllëzuar ndodhet një vend kah i bartnin drunjtë anëtarët e familjes së Sadri Rexhep Ahmetajt.

*Gërla (J).* — Është një kanjon përafërsisht me gjatësi 2 km. i formuar nga uji i Skafkaçit, i cili hidhet dhe rrjedh në brendi të shkëmbit, duke e gërryer shkëmbin, dhe nga kjo gërryerje quhet *gërri*.

*Skâqet (JP).* — Është një rreth në periferinë e Leskovës i pasur me kullota. Mendoj së del nga fjala *shkajç* pasi ndodhet në skajet e vendit të përmendur, duke përfshirë vendin gjer në rrëzë të Podgojës (bjeshkës) dhe Pajishtës.

*Podgoja (JP).* — Është një bjeshkë ku dalin për të veruar familje të ndryshme nga fshatra të ndryshme. Fjala Podgojë mendojmë se del nga ajo se e ka formën e PODIT e (dyshemesë) dhe të gojës, pjesërisht të rrafshët që anon më tepër kah pjerrtësia. Fjala pod përdoret edhe dysheme që ka përdorim të përhershëm në këto anë.

*Pllana e Fierit (L).* — Është një sipërfaqe e pjerrët në të cilën rritet një bimë e quajtur FIER.

*Ograja (L).* — Një vend i pasur me kullota.

*Lugu i Morajzave (L).* — Në këtë luginë rriten drunj murrizash, nga e ka marrë emrin Morajza.

*Zharet e Ropojanit (JP).* — Është shpatinë shkëmbore e pasur edhe me kullota, për të cilën thuhet se ka qenë e pyllëzuar por është djegur e bërë pluhur.

*Zharet e Mërmatan's (JL).* — Ndodhen në territorin (në vendin) e quajtur Mërmatanë. Quhën kështu sepse e kishte djegur këtë pyll një fshatar vendas.

*Mërmatana (JL).* — Është bjeshkë ku dalin për të veruar banorë të fshatit Vuthaj. Fjala zberthehet ngjashëm me atë Zagorje. Pra kjo bjeshkë gjendet përtej tëbanave të Melo Syl Vuçetajt. Pra është fjalë sllave që d.m.th. *iza stana*.

*Dbanet e Melo Sylê (JL).* — Është vend, ku i kanë vendosur tëbanat disa vuçetas. I pari i ndërtoi Melo Sylë Vuçetaj.

*Dbanet e Shpên Qerimit (JP).* I kishte ndërtuar individi i quajtur Shpend Qerim Gjonbalaj. Ndodhen në territorin e Ropojanit.

*Arat e Pish's (JL).* — Është territor në të cilin rritet shumë druri i Pishës. Prandaj e quajnë kështu.

*Mokna (L).* — Është një sipërfaqe e pjerrët në të cilën ka kullota, livadhe etj.

*Oterrgu i Shogut (JL).* — Është vend ku zhvillohen dimrit, vjeshtës dhe pranverës orteqe (si i quajnë vendasit OTËRGJE). Quhet i Shogut, sepse u rritka druri i shtogut.

*Zalli i Vuthê (J).* — Është një sipërfaqe, të cilën nuk e shfrytëzon askush individualisht, por bashkërisht, vend zallor ku më përpara gjatë festave të ndryshme fetare dhe kombëtare mblidheshin vendasit dhe bënin gara në gjuajtjen e gurit dhe luanin lojëra të ndryshme.

*Qokishtat (JP)*. — Është një vend pjesërisht i pasur me kullota, ku ka gurë e shkëmbinj. Meqë aty-këtu ka kullota quhet Qokishta, që d.m.th. qok-qok dhe i është prapangjitur prapashtesa *ishta*.

*Leqja e Kukê (J)*. — Pranë shtëpisë së Ismajl dhe Zymber Kukajt ndodhet një rrugë me kthesa (leqe), nga e quajnë Leqja e Kukê meqë të shpjerë tek ajo shtëpi.

*Beglleku i Gjobalê (P)*. — Është një sipërfaqe e madhe e fushore, në të cilën kullot bagëtia, luajnë fëmijët etj.

*Hasanajt (JP)*. — Është një lagje, banorët e së cilës kanë prejardhje nga individi i quajtur Hasan. Edhe këta janë pjesëtarë të Gjonbalajve.

*Hejdet e Ropojanit (JP)*. — Qenka rritur një bimë e quajtur HEJDE.

*Rrasat e Lagta (J)*. — Janë disa rrasa mbi të cilat ka lagështi sepse mbi to rrjedh ngapak ujë.

*Qarrishta (L)*. — Është një sipërfaqe e pjerrët, në të cilën rritet QARRI, prandaj e quajnë kështu.

*Rrathë e Blet's (P)*. — Rreth e përqark Shpellës së Bletëve rritet druri dhe ekziston një shkëmb që ka pamjen e rrathëve.

*Pusi Pafun (P)*. — Është pus shumë i thellë, prandaj e quajnë të pafund.

*Bûni i Lulash Smajlit (JP)*. — Lulash Smajli paska veruar në këtë vend, ku i ka vendosur njerëzit e vet dhe bagëtitë.

*Zharet e Kodrës Liqenit (JL)*. — Janë shpatina të territorit të bjeshkës së Kodrës së Liqenit, të cilat qenkan djegur.

*Runicat (JL)*. — Është një vend ku thuhet se paskan nxjerrë xehe. Ndodhet në jug të Gjollave të Zastanit.

*Istikamet e Turkisë (Ilogoret) (VL)*. — Këtu i paskan ndërtuar turqit Ilogoret për t'u mbrojtur nga vendasit e të tjerët.

*Mrizet e Synit (J)*. — Pranë burimit të quajtur SY ndodhet një pyll, në të cilin barinjte i paskan mrizuar delet.

*Lugu i Ponice (JL)*. — Në gjolla të Zastanit ndodhet një luginë, e cila paska disponuar lëndë aq të mira nga e cila qenkan nxjerrë ponica-dërrasa të përshtatshme për dysheme etj., për çfarë shkakut e quajtën Lugu i Ponice.

*Gjollat e Mërmatan's (JL)*. — Ndodhet një vend i përshtatshëm, ku u qitet kripë deleve.

*Shpella e Fratit (JP)*. — Mbi skâqe ndodhet një shpellë, në të cilën ndodhet një kryq. Thuhet se një prift paska jetuar këtu në kohën kur ka zënë të përhapet me të madhe nga turqit myslimanizmi. Në këto anë nuk dihet kush ishte dhe nga ishte ai prift.

*Sukat (J)*. — Është një vend i përshtatshëm për kullota, ku ka edhe shkëmbinj në formë të rrasave, të cilat quhen SUKA. Fjala *Suka* mendojmë se del nga fjala *rrasuka*, *rrasë*, por duke ua hequr parashtesën *-ra*, sikur është shkëmb në formë rrase.

*Sukat e Kukê*. — Janë pronë e një familjeje e cila del nga vëllazëria e kukajve.

*Lugu i Vuthê.* — Kështu quhet fshati Vuthaj meqë ka formën e luginës

*Buzbrek (J)* — Qëhet një vend që ndodhet pranë një bregu.

*Pusi i Jeftit (P).* — Është një pus, i cili ndodhet në territorin e pasurisë së individit të dikurshëm, Jeftit.

*Brada (VP).* — Është një bjeshkë në të cilën verojnë shumë familje.

*Bjeliçi (L).* — Është një bjeshkë në të cilën verojnë shumë familje. Thuhet se Bjeliç qenka quajtur një individ që e paska pasur këtë bjeshkë të vetën.

*Români (JL).* — Është bjeshkë ku dalin me bagëti shumë familje. Nga vendasit thuhet se kjo bjeshkë ka qenë pronë e romakëve (pas pushtimit që ia bënë) nga edhe quhet kështu.

*Komlemi (JP).* — Është bjeshkë ku dilnin familje për të veruar.

*Bori (L).* — Është bjeshkë e përshtatshme për kullota. Mendojmë se quhet Bori sepse kur bie borë shihet mirë meqë pjesa e sipërme e kësaj bjeshke është e zhveshur. Pra është e bardhë si bora.

*Qafa e Borit (L).* — Është po ashtu bjeshkë që ndodhet në formë të qafës.

Siç shihet toponimet dhe mikrotoponimet e fshatit Vuthaj janë shqipe, të cilat dëshmojnë për jetën e përhershme të shqiptarëve në këtë vend.

